

**VENDIM**  
**Nr.427, datë 27.4.2009**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.1, DATË 7.1.2009 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR PAJISJEN, PËR HERË TË PARË, ME LETËRNJOFTIM TË**  
**SHTETASVE SHQIPTARË DHE PËR PËRCAKTIMIN E AFATEVE E TË MASAVE**  
**SHTRËNGUESE PËR ATA, QË NUK APLIKOJNË BRENDË KËTYRE AFATEVE”, TË**  
**NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 179 të ligjit nr.10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë“, të neneve 1 e 3, pika 2, të ligjit nr.8952, datë 10.10.2002 “Për dokumentin e identitetit të shtetasve shqiptarë” dhe të ligjit nr.9972, datë 28.7.2008 “Për ratifikimin e kontratës koncesionare, për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike, ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe grupimit të SAGEM Securite e Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr.1, datë 7.1.2009 të Këshillit të Ministrave “Për pajisjen, për herë të parë, me letërnjoftim të shtetasve shqiptarë dhe për përcaktimin e afateve e të masave shtrënguese për ata, që nuk aplikojnë brenda këtyre afateve”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

- a) në pikën 4, afati “15 prill 2009” bëhet “30 prill 2009”;
- b) Në pikën 4/1, afati “1 prill 2009” bëhet “1 korrik 2009”.

2. Vendimi nr.332, datë 1.4.2009 i Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.1, datë 7.1.2009 “Për pajisjen, për herë të parë, me letërnjoftim të shtetasve shqiptarë dhe për përcaktimin e afateve e të masave shtrënguese për ata, që nuk aplikojnë brenda këtyre afateve””, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**